

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**PLOTËSIM NDRYSHIMI I MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT**

**ndërmjet**

**Ministrisë së Drejtësisë së Republikës Kosovës**  
**dhe**  
**Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës**  
**për**

**“Themelimin e Njesisë së Ekstradimit të të Pandehurve të kërkuar nga Drejtësia Kosovare”**

Në pajtim me paragrafin 3 të Dispozitave të Fundit të Memorandumit të Bashkëpunimit mes Ministrisë së Drejtësisë së Republikës Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës për “Themelimin e Njesisë së Ekstradimit të të Pandehurve të kërkuar nga Drejtësia Kosovare” (këtej e tutje “Memorandumi”), të lidhur me 4 Maj 2010, Ministria e Drejtësisë propozon këtë plotësim/ndryshim të Memorandumit, si në vijim:

**Neni 1**

Neni 2 i Memorandumit ndryshohet si në vijim:

**Neni 2**

**Kontributi i Ministrisë së Drejtësisë**

Ministria e Drejtësisë merr përsipër të gjitha shpenzimet që dalin nga ky Memorandum në pajtim me Udhëzimin për Udhëtime jashtë vendit.

**Neni 2**

Neni 3 i Memorandumit ndryshohet si në vijim:

**Neni 3**

**Kontributi i Ministrisë së Punëve të Brendshme**

Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me Policinë e Kosovës do të bëjë përzgjedhjen e zyrtarëve policore që do të emërohen në Njësinë për Ekstradim te përbërë prej jo më shumë se 20 zyrtar policor.



**Neni 3**

Pas dispozitave të fundit të Memorandumit shtohen neni 4 dhe 5 si në vijim:

**Neni 4**

**Ndryshimet**

Ky Memorandum mund te ndryshohet me propozimin e cilësdo palë nënshkruese.

**Neni 5**

**Hyrja ne fuqi**

Plotësim/ Ndryshimi i Memorandumit hyn ne fuqi në ditën e nënshkrimit.


Prishtinë më 27. 05. 2013 në dy kopje origjinale autentike në gjuhën shqipe.

**PËR MINISTRINË E DREJTËSISË  
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**PËR MINISTRINË E PUNËVE TË BRENDSHME  
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**Prof. Dr. Hajredin Kuçi  
Zëvendës Kryeministër  
dhe Ministër i Drejtësisë**

**Dr. Bajram Rexhepi  
Ministër i  
Punëve të Brendshme**



\_\_\_\_\_